



KONTRATE PER THEMELIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "M.A.B-2006" SHPK

Ne, Tirane, sot me date 28.01.2006 (dymije e gjashte) shtetasit:

1. **Besnik LESKAJ**, i biri i Astritit, datelindjes 30.06.1976, banues ne Tirane, rruga, Bajram Curri, Pallati 6, Shkalla 1, apartamenti 12, me arsim te larte, dega, administrim- biznes.

2. **Arta GURABARDHI**, e bija e Xhemilit, datelindjes 20.09.1977, banues ne Tirane, rruga, Bajram Curri, Pallati 6, Shkalla 1, apartamenti 10, me arsim te larte, dega finance.

Te larpermendurit jane madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar me vullnetin e lire e te plote, vendosen te krijojne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "M.A.B-2006", SHPK.

HYRJE

1. Ne kuptimin e kesaj kontrate, jane palet, ortaket themelues te Shoqerise "M.A.B.-2006", SHPK.

2. Ortaket themelues, do te ushtrojne veprimtarine private, ne perputhje me dispozitat e ligjit "Mbi shoqerite Tregtare". Ata kane te drejta dhe detyrime te perbashketa, te cilat percaktohen hollesisht ne kete kontrate dhe statutin e Shoqerise.

3. Qellimi i kesaj kontrate eshte themelimi i shoqerise "M.A.B.-2006" SHPK, me qender ne Tirane, dhe shtrirje ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise.

OBJEKTI

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte si vijon:

"Keshillime per bizneset mbi sherbimet bankare, keshillime te sigurimit te llojeve te ndryshme, keshillime per financime te ndryshme, modelimi i biznesit, keshillime mbi ristukturimin e organizimin financiar, studime tregu, studime plan biznesi, keshillime ne fushen e taksave, analiza per industri te ndryshme, analizim i strukturave operacionale te kompanive, modelim i operimit optimalte strukturave operative financiare, keshillime financiare per performancen e kompanise ne treg, ne krahasim me degen e industries qe operon, analiza e vleresim biznesi, keshillime mbi transaksionet e shitjeve dhe analiza per strategjine e shitjeve, keshillime mbi partnership te ndryshem dhe negocime te termave te marreveshjes, keshillime mbi vleresimin e asetave te kompanive dhe te asetave



2.

njerezore, asistime ne pregaditjen e Raporteve Vjetore, vleresim risku dhe keshillime per mitigimin e tyre, ristrukturimin e bizneseve ne veshtersi, keshillime dhe asistencence ne mardhenje me institucionet financiare, keshillime dhe bashkepunime me dhe per sektorin publik, studime fisibiliteti.”

AFATI I VEPRIMTARISE

1. Aktiviteti i Shoqerise “M.A.B.-2006”, SHPK do te zhvillohet ne nje afat mbi 10(dhjet) vjet. Kontrata, do te jete efektive, nga dita e regjistrimit ne Gjykaten e Shkalles se Pare, Tirane, si dhe pajisjen me lejen perkatese te ushtrimit te veprimtarise.

KAPITALI I SHOQERISE

1. Kapitali baze i Shoqerise “M.A.B.-2006”, SHPK perbhet nga kontributi fillestar i ortakeve themelues te investuar perkatesisht; *ne shumen 100000 lek*

| | | |
|--------|------------|----------------------|
| Besnik | LESKAJ | 50(pesdhjet perqind) |
| Arta | GURABARDHI | 50(pesdhjet perqind) |

2. Ortaket, kane te drejte ,qe me nxjerrjen e balanceve periodike ose vjetore te perfitojne perqindjet e realizuara sipas kuotave te percaktuara ne statutin e shoqerise.
3. Shoqeria mban pergjegjesi, per te gjitha detyrimet fiskale, sigurimet shoqerore, shendetesore dhe ndaj te treteve, etj.
4. Per shkeljet e mundeshme e te ndryshme, ortaket themelues, mund te marrin masa disiplinore ndaj kujdo pavaresisht, ne se shkelja eshte bere me dashje apo nga pakujdesia.

JURIDIKSIONI

1. Shoqeria e rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me statutin e saj dhe aktet ligjore te Republikes se Shqiprise.
2. Te gjitha mosmarveshjet me organet shtetore , me personat juridik e fizik vendas e te huaj zgjidhen me mirkuptim, ne te kundert palet mund t'i drejtohen ne Gjykaten e Shkalles se Pare, Tirane.
3. Shoqeria ka qendren ne adresen, Tirane, rruga”Myslym Shyri Nr.5/1.

THEMELUESIT

Besnik
Besnik LESKAJ
Besnik Leskaj

Arta GURABARDHI




3.

Republika e Shqiperise
Dhoma e Noterise Tirane
Nr. *272* Rep
Nr. *93* Kol

VERTETIM

Vertetohet se sot me date *09*. 02.2006(dymije e gjashte), u paraqiten personalisht, ne Zyren e Noterise, Tirane, para meje noterit *S. H. H. H.* shtetasit:
1. Besnik Leskaj, i biri i Astritit, datelindjes 30.06.1976, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta Z.0317544. 2. Arta Gurabardhi, e bija e Xhemilit, datelindjes 20.09.1977, per identitetin e se ciles u sigurova nga pasaporta Z.1298072. Te dy madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet deklaruan se me vullnetin e tyre te lire e te plote, jasht kesaj zyre, kane perpiluar kontraten e dates 28.01.2006 "Per themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "M.A.B-2006", SHPK, Tirane, te cilet e nenshkruan para meje dhe une noterit e vertetojne baze te ligjit.

NOTERI
Bashkim Foxa
[Signature]





STATUT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“M.A.B-2006”SHPK

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “M.A.B-2006”SHPK, Tirane, krijohet, ne baze te kontrates se themelimit, date 28.01.2006, (dymije e gjashte), midis paleve. Shoqeria eshte person juridik i pavarur, privat me te drejta dhe detyrime, per te cilat pergjigjet brenda kufijeve te percaktuar ne ligj.

NENI 2

Shoqria ushtron aktivitetin ne baze te ekonomise se tregut te lire. Baza ligjore eshte ligji 7638, date 19.11.1992”Per Shoqerite Tregtare” si dhe çdo akt tjetër, nxjerre ne plotesim tij.

NENI 3

Themeluesit, ne kete sipermarje, kane bashkuar kapitalin e tyre, me qellim qe te sigurojne fitimin e njohur me ligj, dhe te perfitojne te ardhurat qe rrjedhin prej saj.

NENI 4

Ortaket, perballojne humbjet, vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

NENI 5

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar”M.A.B.-2006”, SHPK, fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin ne Gjykatën e Shkalles se Pare, Tirane, si dhe me pajisjen me lejen perkatese te ushtrimit te profesionit.

EMRI.QENDRA.TERITORI

NENI 6

Emertimi i Shoqerise eshte: Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar”M.A.B.-2006” SHPK, Tirane.

NENI 7

Shoqeria mban vulen e saj, ne ne forme rrethore ose katerkendeshe kendrejte me emertimin e mesiperm.

NENI 8

Qendra e Shoqeriae eshte ne adresen, Tirane, rruga”Myslym Shyri” Nr.5/1.

NENI 9

Shoqeria, do te ushtroje aktivitetin e saj ne Tirane, ku do te jene organet drejtuese te saj. Ajo, mund te shtrije veprimtarine, ne te gjithë teritorin e Republikës se Shqiperise si dhe jasht saj.

NENI 10

Ne objektin e veprimtarise perfshihen:

“Keshillime per bizenet mbi sherbimet bankare, keshillime te sigurimit te llojeve te ndryshme, keshillime per financime te ndryshme, modelim i biznesit, keshillime mbi ristruktutimin e organizimin financiar, studime tregu, studime plan biznesi, keshillime ne fushen e tatim-taksave, analiza per industri te ndryshme, analizim i strukturave operacionale te kompanive, modelim i operimit optimal te strukturave operative financiare, keshillime financiare per performancen e kompanise ne treg ne krahasim me degen e industries qe operon, analiza dhe vleresim te biznesit, keshillime mbi transaksionet e shitjeve dhe analiza per strategjine e shitjeve, keshillime mbi partnershipe te ndryshem dhe negociime te termave te marreveshjes, keshillime mbi vleresimin e aseteteve te kompanive dhe te aseteteve njerezore, asistime ne pergatitjen e raporteve vjetore, vleresime risku dhe keshillime per mitigimin e tyre, ristrukturime te bizneseve ne veshteresi, keshillime dhe asistenc ne mardheniet me institucionet financiare, keshillime dhe bashkepunime me dhe per sektorin publik, studime fisibiliteti”.

AFATI I VEPRIMTARISE**Neni 11**

Aktiviteti i shoqerise, do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar mbi 10(dhjet)vjet, duke ju nenshtruar te gjithe rregullave te percaktuara ne legjislacionin Shqiptar.

KAPITALI I SHOQERISE**NENI 12**

Kapitali baze, perbehet nga kontributi fillestar i ortakeve themelues ne vleften 100.000 leke. Kapitali eshte investuar perkatesisht:

| | |
|--------------------|----------------------|
| 1. Besnik LESKAJ | 50(pesdhjet perqind) |
| 2. Arta GURABARDHI | 50(pesdhjet perqind) |

NENI 13

Kapitali themeltar, mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise se shoqerise. Zvoglimi i tij, ne nje vlere me te vogel se kufijte e percaktuar ne ligj e detyron shoqerine te shnderrohet ne nje forme tjeter. Zvoglimi i kapitalit themeltar prek ortaket ne perputhje me perqindjet e investuara nga sejcili.

NENI 14

Ortaket kane te drejte te transferojne pjeset e kapitalit themeltar sipas dispozitave te legjislacionit Shqiptar. Transferimet duhet te vertetohen me akt noterial.

DREJTIMI ADMINISTRATIV**NENI 15**

Shoqeria, "M.A.B-2006", SHPK, Tirane, do te kete si administrator Z. Besnik

LESKAJ.

NENI 16

Administratori ka per detyre, te drejtoje veprimtarine e shoqerise, sipas kompetencave te dhena nga asamblea e ortakeve.

NENI 17

Ne mardhanje me te tretet, administratori e angazhon shoqerine nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj, dhe kompetencat e tij. Shoqeria mere persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit.

NENI 18

Administratori, mund te kryej te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqrise. Per çeshtjet ne ndjekje, ai pregadit raportin, i cili i paraqitet per miratim asamblese se ortakeve.

NENI 19

Administratori, eshte pergjegjes ndaj shoqerise, te treteve, per shkelje te statuti, apo ligjeve te shtetit gjate administrimit te shoqerise.

NENI 20

Administratori i ka te gjitha kompetencat, per te vepruar me organet shtetore, personat juridik e fizik vendas a te huaj ne emer te shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe statuti ia njej asamblese se ortakeve.

NENI 21

Asambleja e ortakeve eshte organ me i larte i shoqerise. Ajo ka ne kompetence:

- *Te miratoje raportin e administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore te hartuara nga administratori apo eksperti kontabel.
- Te vendos per ndryshimin e statutit te shoqerise.
- Te vendos per ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve.
- Rregullon mardheniet e punesimit dhe te shperblimit si dhe kushtet e punes.
- Te vendos per shperberjen e shoqerise ose shnderimin e saj ne nje forme tjeter.
- Percakton masat ndeshkimore ndaj personave qe kane thyer statutin apo ligjet e shtetit.
- Percakton detyrimet ndaj organeve shtetore, si dhe personave juridik e fizik a te huaj.

NENI 22

Asambleja e ortakeve, mund te caktoj si administrator edhe persona te tjere qe nuk bejne pjese ne radhet e ortakeve themelues. Administratori i zgjedhur shkarkohet me vendim te asamblese se ortakeve, ne rastet e parashikuara ne nenin 21 te ketij statuti.

NENI 23

Ortaket themelues, kane te drejte te njihen ne çdo kohe me dokumentacionin e shoqerise dhe sipas kompetencave te percaktuara ne ligjin "Per shoqerite tregtare", mund

A handwritten signature in black ink, appearing to be the signature of the administrator mentioned in the text.

A second handwritten signature in black ink, likely representing another official or the notary.

te autorizojne persona te tjere me cilesine e perfaqesuesit.

KREU- II MARDHENIET FINACIARE

NENI 24

Shoqeria mund te lidh kontrata, me sektoret shtetore ose me person juridik e fizik vendas a te huaj. Ne veprimet kontraktuale, shoqeria perfaqesohet nga ortaket ose nga administratori. Te drejtat dhe detyrimet qe rjedhin nga aktet e administratorit nepermjet kontraktive jane te detyrueshme per shoqerine.

NENI 25

Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes tij, detyrimet ndaj shtetit, sigurimet shoqrore e shendetesore, etj.

NENI 26

Shoqeria ka te drejten te marre kredi nga bankat e vendit ose huaja ne Shqiperi, si dhe te çele llogari rrjedhese prane tyre.

NENI 27

Per pasqyrimin e aktivitetit te shoqerise, administratori eshte i detyruar, te mbaj dokumentacionin financiar dhe regjistrat perkates, si dhe te bej deklarimin e te ardhurave ne organin tatimor perkates.

MARDHENIET E PUNESIMIT

NENI 28

Mardheniet e punesimit, r regullohen sipas kontrates se punes, qe lidhet ndermjet paleve. Marrja ne pune, behet me regjistrimin e punonjeseve ne librin e punes te juridiksionit perkates.

NENI 29

Ne kontraten e punes, percaktohen kushtet, afatet, shperblimet, si dhe pushimet.


NENI 30

Ndryshimi i vendit te punes ose largimi nga shoqeria behet ne baze te nje akti me shkrim, te vendosur nga asamblea e ortakeve. Personi qe largohet, duhet te bej dorzimet e detyres ne baze te nje akti me shkrim, mbasi te kete likujduar detyrimet ndaj shoqerise.

KREU-III BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 31

Shperblimi per personat e punesuar caktohet sipas kontrates se punes. Ndryshimi ne page vendoset nga asamblea e ortakeve.




**NENI 32**

Te ardhurat neto te ortakeve, percaktohen sipas kontributit te tyre ne kapitalin themeltar, pasi shlyen detyrimet fiskale, sigurimet shoqerore e shendetsore, etj.

NENI 33

Te ardhurat do te sigurohen sipas çmimeve qe cakton shoqeria. Çmimet dhe tarifat caktohen sipas kerkesave e ofertes.

SHPERNDARJA E SHOQERISE**NENI 34**

Shoqeria perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te kapitalit themeltar.

NENI 35

Ne rastet qe kaptalet e shoqerise rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit baze, ortakët vendosin mbi mundesine e prishjes se parakoheshme te shoqerise dhe mund te kerkojne ne Gjykate prishjen e saj.

NENI 36

Asambleja e ortakeve, ne rastet kur kerkohet mbyllja e aktivitetit te shoqerise, percakton shlyerjen e detyrimeve ndaj te treteve, cakton likujdatorin dhe menyren e likujdimit.

DISPOZITAT E FUNDIT**NENI 37**

Mosmarveshjet e shoqerise, me persona juridik e fizik vendas e te huaj, ne rast se nuk zgjidhen me mirkuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Shkalles se Pare, Tirane.

NENI 38

Persa s' eshte shprehur ne kete statut i referohet ligjit, "Per shoqerite Tregtare", dhe ç' do ligji tjeter, qe rregullon veprimtarine e shoqerive tregtare ne teritorin e Shqiperise.

Statuti perpilohet ne 4(kater) kopje dhe nenshkruhet rregullisht.

Statuti u perpilua ne Tirane, sot me date, 28.01.2006.

THEMELUESIT

Arta GURABARDHI

Besnik LESKAJ